

FERDINAND LEKA

ASPEKTE TË ZHVILLIMIT TË TERMINOLOGJISË TEKNIKO-SHKENCORE PAS ÇLIRIMIT

Terminologjia tekniko-shkencore ka ecur shumë përpara gjatë këtyre 25 vjetve. Zhvillimi i pandërprerë i shkencës dhe i teknikës në vëndin tonë, pra faktorë që është bërë zakon t'i quajmë jashtëgjuhësorë, e kanë pasuruar gjuhën tonë me fjalë-terma të sferave më të ndryshme të veprimtarisë. Një pjesë e mirë e këtyre emërtimeve të reja i kalojnë caqet relativisht të ngushta të terminologjive speciale dhe depërtojnë në leksikun e zakonshëm. Kështu edhe kufinj të këtij të fundit vinë përherë duke u zgjeruar. Një shumicë fjalësh-terma, që pak kohë më parë njiheshin nga një numër i kufizuar specialistësh, bëhen të njohura nga një rreth përherë e më i madh njerëzish, për hir të kontaktit të këtyre me teknikën moderne, në sajë të ngritjes kulturore dhe profesionale të masave punonjëse.

Të kapësh në mënyrë të gjithanshme zhvillimin e gjerë që është vërtetuar në terminologjinë shkencore të viteve pas çlirimit është një punë e vështirë, si për shkak të sasisë së madhe të termave speciale që përdoren sot në fushat më të ndryshme të veprimtarisë, po ashtu edhe për mungesën e mbledhjes dhe të ndarjes së tyre në mënyrë sistematike, d.m.th. sipas fushave të përdorimit. Nga ana tjetër nuk është e lehtë për gjuhëtarin të futet në përmbajtjen e termave tepër speciale e shpesh përfundimet e veta me karakter gjuhësor detyrohet t'i nxjerrë nga një material i kufizuar për të cilin ka njohuri më të përpikta.

Përsa i takon shtrirjes në kohë, megjithëse kjo është relativisht e shkurtër, zhvillimi i gjuhës është kaq i vrullshëm e i thellë në disa aspekte, sa që na lejon ta shohim qartë zhvillimin dhe ngulitjen e disa fenomeneve të mishëruara në terma të ndryshëm.

Ndër tiparet themelore që bien në sy në lëmin e terminologjisë është pasurimi i madh i kësaj të fundit me terma të rinj nga burime të ndryshme, nga të cilat më kryesoret janë këto:

1 — Fjalë të gjuhës së përditshme të përdorura me një kuptim më të ngushtë, më special. Të tilla janë p.sh. fjalët *thjerrëz*, *bërthamë*, *thërmi* etj. që përdoren sot gjerësisht në terminologjinë e fizikës. Shpesh përdorime të tilla janë bërë me anë të kalkimit.

2 — Fjalë të rralla ose dialektore të përdorura me një kuptim të caktuar si *ardhangie* (fryrje e një organi nga lëngje të ndryshme, fr. *turgescence*), *zhardhok* (pjesë mishatake e bimës që rritet në një anë çfarëdo të trupit të saj, por më tepër në rrënjë, fr. *tubercule*).

3 — Krijime neologjizmesh, për pasurimin e gjuhës me terma të

rinj, për zëvendësimin e disa fjalëve të huaja, natyrisht duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të gjuhës.¹⁾

4 — Huazime fjalësh ndërkombëtare.²⁾

Në këtë punim do t'u hedhim një vështrim disa formimeve që janë më karakteristike për terminologjinë dhe do të çekim ndonjë problem më të diskutueshëm, siç janë p.sh. *çështja e huazimeve, e përdorimit të mbiemrave, e fjalëve abstrakte*.

Një tip emërtimi që po bëhet mjaft prodhues në lëmin e terminologjisë është togfjalëshi *emër + një emër tjetër* që bashkohet me të parin si ndajshim dhe semantikiisht kryen funksione të ndryshme. Kështu në termat: *tryelë elikë, sharrë disk, limë piatë, vinç kullë*, emri i dytë tregon formën e të parit, pra tryelë në formë elike, sharrë në formë disku etj. Në këtë rast emri ndajshim kryen funksionin e një mbiemri që mungon, ashtu siç ndodh edhe në gjuhën e përditshme (khs. trim drague; qen ujk, problem kyç).

Në disa raste emri i dytë tregon funksionin që kryen emri i parë. Në termat *portë-pritë, daltë-turielë, kënd-cak*, kuptimi është «portë që shërben si pritë», «daltë që shërben si turielë ose bën punën e turielës», «kënd që shërben si cak (limit)».

Duhet vënë në dukje se këto togje kanë një farë prirjeje të shkrihen në kompozita siç mund ta vërejmë në fjalën *udhëkryq*. [Forca të mëdha të policisë kishin bllokuar *udhëkryqet* — Zëri i Rinisë, 9.X.1968, f. 6] ose në neologjizmin *kodërvarr*.

Një tip fjalëformimi që meriton të vihet në dukje në mënyrë të veçantë në terminologjinë teknike dhe shkencore është ai që përbëhet nga një grup fjalësh të lidhura ndërmjet tyre me parafjalë ose vetëm me trajta rasore të emrit (zakonisht me gjindore ose rrjedhore). Këta terma prej disa fjalësh po përhapen gjithnjë e më tepër në fushat e ndryshme të terminologjisë tekniko-shkencore. Të tilla janë: *elektroskop me fletë, shfrytëzim me galeri, trapano me vidhë, komplet bobinash, vija rikumbimi* etj. Modelin e këtyre e gjejmë në gjuhën e përditshme, në grupime të tilla si: *yll me bisht, njeri me huqe, mi fushe, roje nate* etj. Rendi i gjymtyrëve në këtë tip është: i përcaktuar + përcaktues dhe si mjet lidhës kemi [kryesisht] parafjalën *me*. Këto togje fjalësh që janë të barasvlerta me një emër, sasdoqë me të njëjtën strukturë, ndryshojnë nga pikëpamja semantike. Përcaktuesi, që është parafjala *me + një emër*, mund të tregojë: 1) tiparin dallues, karakteristikën themelore të një objekti si p.sh.: *elektrometër me disqe, elektroskop me fletë, elektrometër me fill*; 2) mënyrën si funksionon një vegël ose mjetin që e vë në funksionim, si p.sh.: *çelës me zgjerim uji, çelës me çekiq, kandil me gaz, maqinë me benzinë* etj.

Terminologjia shqipe është pasuruar shumë edhe me emra abstraktë. Nevoja për termat abstraktë lidhet me zhvillimin e prodhimit e të mendimit shkencor dhe me mundësitë për ta shprehur këtë me mjete gjuhësore sa më të përpikta e më të kursyera³⁾.

Ndër emrat abstraktë prapashtesa *-ëri*, që dikur ka ngjallur diskutime ndërmjet gjuhëtarëve,⁴⁾ sot mund të thuhet se ka fituar të drejtën

1), 2) Shih F. Leka — S. Morecka, *Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit*, «Studime filologjike», Nr. 4, 1969.

3) Shih A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*. *Buletin për shkencat shoqë. 1956, IV f. 24-25.

4) Shih A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Tiranë 1956, f. 99; L. Dodbiba, *Vërejtje rreth pastrimit të terminologjisë*, «Buletin i shkencave shoqërore», 1956, II. f.

e qytetarisë jo vetëm në ndonjë term të veçantë por edhe në fjalë mjaft të njohura e të një përdorimi jo të rrallë si: *ndjeshmëri*, *ngjashmëri*, *prodhueshmëri*, *ligjshmëri*, *partishmëri* etj. Krahas këtyre kemi një kategori neologjizmesh me prapashtesat *-si*, *-i*, *-ëri* që sapo kanë filluar të depertojnë në gjuhë: *kripësi* (fr. salinité), *oksidueshmëri* (fr. oxidabilité), *pashmëri* (fr. visibilité), *shtangëti* (fr. rigidité), *përppjestimi* (fr. proportionalité) *njëkohësi* (simultaneité). Përveç këtyre emrave abstraktë me tema shqipe janë bërë përpjekje edhe për krijimin e një vargu emrash të tjerë që ruajnë temën e huaj. por marrin prapashtesa shqipe. Të tillë janë p.sh.: *molarësi* (fr. molarité, rus. молярность), *kapilarësi* (fr. capillarité, rus. капиллярность) *apolarësi* (fr. apolarité, rus. аполлярность), *plastikësi* (fr. plasticité, rus. пластичность). Këta terma hibridë duhen parapëlqyer në krahasim me fjalët krejt të huaja që ende mbizotërojnë në gjuhën tonë si: *kapilaritet*, *plasticitet* etj. Prapashtesa shqipe i «inkuadron» mirë ata terma brenda sistemit të gjuhës sonë dhe i bën më të kuptueshëm, më të kapshëm për shqipfolësin. Në lëmin e terminologjisë duhet shfrytëzuar fuqia e madhe asimiluese e shqipes, e cila fjalëve të huazuara u jep mbaresa e prapashtesa të vetat. Ruajtja e fleksionit i jep një gjallëri të madhe gjuhës sonë dhe është një fitim i dukshëm në krahasim me ato gjuhë që e kanë humbur.⁵

Një kategori gramatikore që po përdoret gjërësisht në terminologji është ajo e mbiemrave. Edhe në gjuhën shqipe mbiemri i krijuar nga një emër konkret ka një kuptim më special se emri nga i cili buron. Kështu ndërsa në gjuhën e përditshme themi: *dhëmbje dhëmbësh*, *njeri i gojës*, togjet: *bashkëtingëllore dhëmbore*, *letërsi gojore* i përkaasin një sferë më të ngushtë, më të specializuar. Mbiemrat janë një kategori shumë e nevojshme për emërtimet terminologjike ku shkurtësia është një ndër kërkesat themelore, krahas nevojës për të shprehur nuanca të ndryshme kuptimore që realizohen me prapashtesa të ndryshme si *-or*, *-të (-ët)*, *-ak*. Më e zakonshme është prapashtesa *-or* me të cilën janë krijuar mbiemra që tregojnë më tepër përkatësi si: *luginor* (burim luginor)⁶, *vatëror*⁷ (pikë vatërore), *krateror* (liqen krateror)⁸. Ndonjëherë kjo mbaresë nuk është përdorur me vend si tek mbiemrat *njëbuzor*, *dybuzor*⁹ (fr. unilabié, bilabié; rus. одногубый, двухгубый) që duan të japin kuptimin «që ka një buzë të vetme» dhe «që ka dy buzë»; frengjishtja dhe rusishtja kanë mbiemrat *labial* dhe *губной* për kuptimin «që ka të bëjë me buzën» (p.sh. *consonne labiale — губной согласный — bashkëtingëllore buzore*). Edhe në shqipen duhej ruajtur ky dallim dhe për kuptimin e parë (fr. unilabié, rus. одногубый) të futeshin mbiemrat *njëbuzësh*, *dybuzësh*, siç kemi *njëngjyrësh*, *dyngjyrësh*, *njërrrokësh*, *dyrrrokësh*, *njëfish*, *dyfish*.

Mbiemrat e nyjshëm me *-të* zakonisht ndër terma tregojnë lëndën nga se përbëhet një send (i drunjtë, i hekur, i çeliktë etj.) Në fjalorin e terminologjisë së botanikës takojmë mbiemrat: *i*, *e dyflegërt*, *i*, *e treflegërt* me kuptim «që përbëhet nga dy flegra», «që përbëhet nga tri

5) P.sh. në gjuhën frenge anglicizmat nuk i nënshtrohen as ortografisë së asaj gjuhe, por hyjnë si «trupa të huaja» brenda frëngjishtes. Shih: Etienne, «Parlez-vous français?» 325-326.

6) *Term. e gjeologjisë*, Nr. 148.

7) *Term. e optikës*, Nr. 454.

8) *Term. e gjeologjisë*, Nr. 647.

9) *Term. e botanikës*, Nr. 212 dhe 728.

flegra». Edhe këtu duhej preferuar mbiemri i tipit numëror + rrjedhore e pashquar shumë, dmth. njëflegërsh, *dyflegërsh*, sipas modelit të fjalëve *njëkatësh*, *dykatësh*, që sot përdoren gjerësisht në gjuhën tonë.

Në disa raste krahas mbiemrit përdoret edhe emri në rrjedhore, si p.sh. në terminologjinë e kimisë ku kemi *ujë gëlqereje* që është trajta popullore e fjalës dhe *ujë gëlqeror* që afrohet më tepër me terminologjinë shkencore.¹⁰ Përvoja na ka treguar se specialistët tërhiqen më tepër nga trajtat me mbiemër se sa nga ato me emër në rrjedhore.

Një ndër çështjet më të diskutueshme, është çështja e huazimeve, duke përfshirë këtu edhe ato që quhen fjalë ndërkombëtare. Gjatë periudhës së Rilindjes ka ekzistuar një prirje për të shqipëruar edhe terma të tillë si *gjeografi*, *aritmetikë*, *gramatikë*, *gjeometri*, me neologjizmat përkatës *dheshkronjë*, *numratore*, *shkronjtore*, *dhematje*, të cilët koha i ka lënë mënjanë. Edhe shqipja shohim se ndjek rrugën e shumicës së gjuhëve europiane, duke shfrytëzuar mjaft terma të krijuar nga latinishtja, nga greqishtja e vjetër ose nga përzierja e elementave të këtyre dy gjuhëve.

Një vend disi të veçantë zënë ata terma që, sidomos në gjuhët neolatine, janë formuar me parashitesa e prapashitesa latine e greke si *anti-*, *auto-*, *orto-*, *hemi-*, *poli-*, *ultra-*, *trans-*, *post-*, *inter-*, *mono-*, *bi-*, *tri-*, *tetra-*, *penta-*.... *-fero-* etj. Në shumë prej këtyre termave janë shqipëruar parashitesa dhe pjesa tjetër e fjalës, si p.sh. në: *vetushqim* (fr. autotrophie); *shumëkëndsh* (fr. polygone), *ndërshtënie* (fr. interpolation), *sheqerbartës* (fr. saccharifère), *naftëbartës* ose *naftëmbajtës* (fr. pétrolifère).

Shqipërime të tilla, që janë në harmoni me natyrën e gjuhës shqipe, nuk tregojnë ndonjë prirje për purizëm të tepëruar, por lindin nga nevoja për t'i vënë një pritë, një kufi, vërshimit të fjalëve të pamotivuara. Një shtim pa kriter i këtyre të fundit, sidomos në ditët tona kur shkenca dhe teknika duhet të përvetësohen përherë e më tepër nga masat, do të krijonte një hendek të kotë ndërmjet fjalëve të fondit të përgjithshëm të fjalorit dhe fjalëve speciale ose termave [fenomen që ka ndodhur p.sh. në frengjishten dhe në anglishten].

Një grup më vete në terminologji përbëjnë edhe fjalët e formuara nga një element shqip dhe një element i huazuar, të cilat i kanë quajtur edhe fjalë hibride. Në disa sfera të terminologjisë numri i tyre është i konsiderueshëm. Mjafton të themi se në fjalorin e terminologjisë së Elektroteknikës, arrijnë të zënë rreth 40% të të gjithë fjalorit. Një shumicë kompozitash janë krijuar me përbërësin *elektro plus një fjalë tjetër* që mund të jetë një fjalë krejtësisht e huaj si *luminishencë* (elektroluminishencë) ose krejt shqip si *ndjeshmëri*, *frenim* (elektrondjeshmëri, elektrofrenim etj.) Ndërmjet këtyre dy skajeve kemi një varg përbërësish që në të vërtetë janë huazime nga gjuhët e huaja, por njihen gjerësisht e mund të konsiderohen si pjesë përbërëse të fjalorit të zakonshëm: të tilla janë *magnet* (elektromagnet), *motor* (elektromotor), *metër* (elektrometër), *pompë* (elektropompë) etj.

Në gjuhën shqipe vërejmë edhe fenomenin e futjes së disa fjalëve me prejardhje latine, që mund të duken si terma specialë por në të vërtetë krijojnë çifte sinonimike të panevojshme, mbasi fjala shqipe e

10) P.sh. gjatë diskutimit të terminologjisë së mekanikës specialistët pëlqyen më tepër termin *forcë sipërfaqësore* se sa *forcë sipërfaqeje*.

kryen funksionin e vet fare mirë. Të tilla janë p.sh. fjalët *medikal, santonar, instrument*, krahas fjalëve shqipe *mjekësor, shëndetësor, vegël*.

Ndryshe qëndron puna kur fjala me prejardhje latine ka hyrë për të shprehur një nocion të ri, si në rastet e fjalëve *skolastik, aksion, operacion, devijim* (deviacion), që kanë kuptime speciale krejt të ndryshme në krahasim me shqipet *shkollor, veprim, shmangje*.

Prandaj në shqipërimin e fjalëve të huaja duhet të ruhem kurdoherë nga një farë simplizmi që mund të vejë në dëm të saktësisë dhe të qartësisë së termit.

Lëmi i terminologjisë tekniko-shkencore e meriton vëmëndjen e gjuhëtarëve, jo vetëm sepse problemi i njësimt, i spastrimit dhe i pastrimit të mëtejshëm të gjuhës me fjalë-terma ka një rëndësi praktike të dorës së parë, por edhe sepse në planin teorik kjo fushë paraqet probleme me interes të veçantë për gjuhësinë, në mënyrë të veçantë për leksikologjinë.

R é s u m é

ASPECTS DU DEVELOPPEMENT DES TERMES TECHNICO-SCIENTIFIQUES APRES LA LIBERATION

Le développement ininterrompu de la science et de la technique durant ce quart de siècle qui vient de s'écouler depuis la libération du pays a enrichi la langue albanaise d'un grand nombre de termes nouveaux des sphères les plus disparates de l'activité humaine.

L'auteur fait ressortir les souches qui ont enrichi davantage le vocabulaire des termes technico-scientifiques.

1) *Mots de la langue quotidienne usités dans une acception spéciale (thjerëz «lentille», bërthamë «noyau», thërmi «bribe = particule», etc.*

2) *Mots rares ou dialectaux usités dans une acception donnée (ardhangie «turgescence», zhardhok «tubercule», etc.).*

3) *Formation de néologismes en utilisant les moyens de formations des mots de la langue.*

4) *Emprunts internationaux.*

L'auteur s'arrête plus particulièrement à quelques types de mots qui sont plus caractéristiques pour le domaine de la terminologie comme les groupes de mots nom + un autre nom qui s'adjoigne au premier comme apposition et indique sa forme (ex.: tryelë elikë «foret hélicoïdale», littéralement «foret hélice»; sharrë disk «scie circulaire», littéralement «scie disque»), ou bien désigne la fonction du premier nom (ex. portë-pritë «vanne», littéralement «porte barrière», kënd-cak «angle limite»), etc. Il y est fait ressortir que ces groupes de mots ont tendance à être considérés comme des composés, comme on peut le remarquer dans des mots tels que udhëkryq «croisée de chemin» (litt. «voie croix»), kodërvar «tumulus, tertre» (litt. «colline tombeau»).

Dans la terminologie de l'albanais est observé encore un autre type de formation des mots, un groupe de mots rattachés entre eux au moyen d'un préfixe (surtout le préfixe me) ou bien avec les formes casuelles du nom (génitif ou ablatif). Tels sont p. ex.: trapano me vidhë «foret à vis», complet bobinash «jeu de bobines», vija rikumbimi «lignes de résonnance», etc.

On fait ressortir l'enrichissement de la langue par des mots abstraits, formés à l'aide des suffixes -ëri, -i, -si, (prodhueshmëri «productivité», shtangëti «rigidité»), ainsi que la grande diffusion d'usage des adjectifs dans la terminologie. L'adjectif formé d'un nom concret a, en albanais aussi, une acception plus spécifique que le nom dont il tire sa source.

En matière d'emprunts, l'albanais aussi suit le chemin de la plupart des langues de l'Europe, en utilisant à cette fin plusieurs termes formés du latin, du grec ou bien du mélange des éléments de ces deux langues.

On doit employer, dans le domaine de la terminologie, la grande capacité d'assimilation de l'albanais, lequel attribue aux mots empruntés des désinences et des suffixes propres. La conservation de la flexion donne une plus grande souplesse à notre langue et représente un bénéfice visible par rapport à ces langues qui l'ont perdue.

Le domaine de la terminologie technico-scientifique mérite l'attention des linguistes, non seulement du fait que la question de l'unification, de l'épuration et de l'enrichissement de la langue par des mots-termes a une portée pratique de premier ordre, mais aussi parce que ce domaine soulève sur le plan théorique des problèmes d'un intérêt particulier à la linguistique, et d'une façon toute particulière à la lexicologie.